



Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF)

INVESTIMET NË KANTINAT E VERËS DHE NDËRTHURJA ME AGROTURIZMIN

Shqipëria është një nga prodhuesit e verës që në lashtësi, e njohur për vreshtat e mbjella në zonat kodrinore. Varietetet kryesore të rrushit autokton shqiptar për verë të kuqe janë Shesh i Zi, Kallmet, Vlosh, Serinë, Debinë e Zezë, ndërsa mes verërave të bardha kujtojmë Shesh i Bardhë, Debinë e Bardhë, Pulës. Rajonet e rëndësishme janë Berati, Vlora, Fieri, dhe Lezha. Zonat me reputacionin më të mirë për verëra cilësore janë Berati, Durrësi, Përmeti dhe Lezha. Berati është rajoni më i rëndësishëm për prodhimin e verës në Shqipëri ku gjenden shumica e kantinave, zonë ku janë fillësat e para të ndërthurjes me agroturizmin, nga ku mund të përmendim kantinën Çobo, Nurellari, Alpeta etj.

Rrush	2000	2010	2015	2016	2017	2018	2019
Prodhimi (ton)	32,522	102,352	122,451	124,437	122,498	110,443	113,833
Sipërfaqja e mbjelle (ha)	5,824	9,712	10,438	10,533	10,695	10,787	10,842
Sipërfaqja ne prodhim (ha)	4,613	8,630	9,891	10,011	10,057	10,179	10,255
Rendimenti (ton/ha)	7.05	11.9	12.4	12.4	12.2	10.9	11.1

Gjatë viteve 2000-2019 kemi një rritje me rreth 100% të sipërfaqes së kultivuar me vreshta, përmirësim të cilësisë dhe prodhimtarisë. Kjo ka bërë që të kemi një ulje të importit të rrushit. Rreth 60% e sasisë së rrushit të prodhuar ka destinacion përpunimit për verë dhe pije të tjera alkoolike. Në Shqipëri operojnë rreth 100 kantina vere por vetëm një numër i kufizuar kanë modernizuar dhe përmirësuar prodhimin e verës dhe kanë investuar për ta ndërthtur atë me aktivitet agroturistik.

VERE	2010	2015	2016	2017	2018
Prodhimi (hl)	30,000	24,500	22,420	25,560	26,800
Import (hl)	25,492	24,871	25,957	27,000	24,515
Eksport (hl)	26		2		
Konsumi (hl)	55,466	49,371	48,375	52,560	51,315
Konsumi per fryme (lit)	51.6	57.9	59.1	54.4	55.7

Industria e verës, duke marrë parasysh prodhimin e brendshëm dhe importin, ka një vëllim prej 15 – 18 milion Euro.

IMPORTET E VERES PER VITET 2000-2018						
Vitet	2000		2015		2018	
	Sasia (hl)	Vlera (USD)	Sasia (hl)	Vlera (USD)	Sasia (hl)	Vlera (USD)
Vere	25,492	6,002,486	24,871	6,876,314	24,515	9,740,335

Disa nga sfidat kryesore të sektorit përfshijnë:

- ❖ Rregullimin dhe formalizimin e tregut informal;
- ❖ Krijimin e sistemeve të koordinimit të duhur ndërmjet fermerëve dhe prodhuesit të verës (koordinimi me fermerin në lidhje me llojin e varieteteve të kultivuara, regjimin e ujitjes, trajtimet, vjeljes etj);
- ❖ Është shumë e rëndësishme të përqendrohemi në prodhime cilësore pasi nuk mund të jemi konkurrues në nivele të larta në sasi me çmim të ulët, por e vetmja mundësi është diversifikimi i produktit me cilësi të lartë dhe çmim të lartë;
- ❖ Ky zhvillim kërkon një përmirësim dhe ngritje të nivelit në fazat kryesore të prodhimit të tilla si maturimi, ambientet, proceset e presimit, linjat e fermentimit, linjat e filtrimit, rezervuarë dhe pajisje paketimi dhe etiketimi etj;
- ❖ Fuqizimi i turizmit do të ndikojë në rritjen e konsumit të produkteve të stinës dhe nënprodukteve të siguruar nga përpunimi, ku prodhimi i verës është kryesor.



Një investim në kantinë vere me kapacitet 300-400 ton verë/vit arrin një vlerë mesatare rreth 1.2 milion Euro, duke përfshirë ndërtimin e ambienteve të përshtatura për këtë aktivitet dhe linja e kompletuar e përpunimit të rrushit (përfshirë depozitat etj).

Investimi i prezantuar mbështetet lehtësisht nga programi i granteve-“IPARD”, fondet kombetare dhe fondi i garancisë së BERZH-it dhe Qeverisë Shqiptare-“AASF”. Financimi i investimeve mund të përfshihet nën programin AASF, duke i ofruar kështu mundësinë bizneseve të përfitojnë nga kushtet lehtësuese të ofruara nga Institucionet Financiare Partnere të programit: ProCredit Bank, IntesaSanpaolo Bank, OTP Bank, Raiffeisen Bank.

Adela Leka, Drejtuese e Projektit

AASF: adela.leka@aasf.com.al

Ilir Pilku, Ekspert i Lartë i Agrobiznesit pranë AASF:

ilir.pilku@aasf.com.al

Për më shumë informacion: <http://www.aasf.com.al>